



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 06.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zona rurale ", Nr. i prokurimit- 632-22-10363-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-114-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K., e dt.03.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zona rurale ", Nr. i prokurimit- 632-22-10363-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-114-521, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 27.09.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.**
- 2. Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 27.09.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K., me dt.03.10.2022, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zona rurale " , Nr. i prokurimit- 632-22-10363-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-114-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 06.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K., të dt.03.10.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishtëm e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Përmirësimi do të bëhet te pika ku kërkohet qe lista e pajisjeve duhet te jete e noterizuar nga Noteri sipas procedurës EN MINUTES;

Sa i përket kërkesave tuaja lidhur me makineritë dhe dëshmitë për makineri, konsiderojmë se është e drejtë e Autoritetit kontraktues se çka do të kërkohet , prandaj ky pretendim i juaji është i pa bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

